



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo**  
**Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva**

## **KUVENDI I KOMUNËS**

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 17 shkronjat e) f) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, Ligjin për financat e pushtetit lokal nr.03/L-049, neneve 14, 15 paragrafi 2.4 dhe 19 paragrafët 1.5 dhe 1.6 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, nenit 3 paragrafi 5 dhe 17 paragrafi 1.5 të Rregullores komunale nr.prot.01-016/01-0030667/22 për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, Vendimit komunal nr.prot.01-401/01-0065086/24 për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2025 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2026-2027, si dhe Vendimit nr.08/165 datë 12.10.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në propozim të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 29 shtator 2025, miratoi këtë,

### **V E N D I M**

#### **PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE – “EKO-LLAPI” SH.A**

##### **Neni 1**

Me këtë vendim i ndahen mjete financiare në shumë 30,000.00€ për subvencionimin e Ndërmarrjes Publike Lokale - “Eko-Llapi” Sh.a.

##### **Neni 2**

Shuma e mjeteve financiare sipas këtij vendimi ndahet nga buxheti i Komunës së Podujevës, kategoria e subvencioneve, (*programi buxhetor 48005-Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik*), dhe ka për qëllim dhënien e ndihmës financiare për shtimin e kapitalit punues.

##### **Neni 3**

Shuma e mjeteve buxhetore sipas këtij vendimi bartet nga Komuna në xhirollogarinë bankare të Ndërmarrjes Publike Lokale - “Eko-Llapi” Sh.A.

##### **Neni 4**

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Buxhetit dhe Financave në bashkëpunim dhe koordinim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik.

##### **Neni 5**

Ky Vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform dispozitave të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, Ligjit Nr.08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, si dhe Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren (QRK) nr.06/2021.

Nr.Prot. 01-400/03-0062887/25  
Podujevë, datë: 29 shtator 2025



Kryesuesi i Kuvendit  
**Hilmi Hoxha**